



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

“Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. nga shoqëritë Loras Holding BV dhe JT International Holding BV”

Në datën 24 Gusht 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë marrëveshjes për shitblerje, të nënshkruar ndërmjet palëve Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. Loras Holding BV dhe JT International Holding BV (pjesë e Japan Tobacco Group), më datë 27 Korrik 2011, me objekt përftimin e kontrollit të shoqërisë Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. nga shoqëritë Loras Holding BV dhe JT International Holding BV nëpërmjet përftimit 100 % të kuotave.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Japan Tobacco Group (JT International Holding BV dhe Loras Holding BV):** ushtron veprimtari në fushën e prodhimit dhe shitjes së cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive dhe të produkteve të tjera të duhanit në 120 vende të botës përfshirë edhe Shqipërinë;
- **Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd.:** ushtron veprimtarinë e saj në Republikën e Sudanit në fushën e prodhimit, importimit dhe shitjes së cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive dhe të produkteve të tjera të duhanit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al